Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 22 tetor 2011

Lënda nr. 07/10

N.G

Kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 22 tetor 2011,
në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga:
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, duke përfshirë edhe përmes mjeteve elektronike në përputhje me Rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës, vendosi si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 1 mars 2010 dhe është regjistruar në të njëjtën datë.

II. FAKTET

2. Ankuesi është banor i Kosovës. Ai ankohet se e drejta e tij për pension invalidor i është mohuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e Kosovës, derisa funksiononte nën UNMIK-un.

III. ANKESA

3. Ankuesi ankohet se përmes marrjes së vendimit, që ndërpret pensionin invalidor, e drejta e tij si person me aftësi të kufizuara është shkelur nga ana e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale e Kosovës, derisa funksiononte nën UNMIK-un.

IV. LIGJI

4. Gjatë procesit të shqyrtimit të pranueshmërisë së ankesës, ka dalë se lënda nr. 07/10 dhe lënda nr. 45/10 janë parashtruar nga i njëjti ankues dhe kanë pasur të bëjnë me të njëjtën viktimë dhe lëndë. Paraprakisht, Paneli ka shpallur lëndën nr. 45/10 si të papranueshme (Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, N.G., nr. 45/10, vendimi i datës 13 prill 2011).

5. Në këto rrethana, në përputhje me Rregullën 29 të Rregullores së punës të Panelit, duhet që lënda nr. 07/10 të hiqet nga lista.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri,

- TË HEQ NGA ANKESËN NGA LISTA E LËNDËVE

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues